



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

RAPORT MBI ANKETIMIN STUDENTOR PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 (SEM. I)

Universiteti Politeknik i Tiranës
Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

HYRJE

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Standardet dhe Kriteret e përcaktuara në Kodin e Cilësisë, Universiteti Politeknik i Tiranës është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) organizon pyetësin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Ky pyetësor organizohet në fund të çdo semestri për të gjitha fakultetet.

DSBC ka organizuar pyetësin studentor nga viti akademik 2017-2018, semestri i dytë e në vazhdim dhe ka hartuar raportet përkatëse të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të UPT.

<https://upt.edu.al/drejtimi-akademik-administrativ/drejtorite/drejtoria-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/>

Më poshtë pasqyrohen në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit, deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e rekomandimeve.

Për 6 Fakultete, pyetësi është realizuar përmes sistemit “Bit-Albania” dhe është administruar nga DCBC, kurse për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, pyetësi është zhvilluar përmes sistemit “pitagora” dhe është administruar nga FIM.

Duke qënë se janë përdorur të njëjtat pyetje/pohime dhe metodologjia e zhvillimit dhe mbledhjes së të dhënave të pyetësorëve ka qënë e njëjtë (si për fakultete që kanë sistemin e sekretarisë “Bit-Albania” ashtu edhe për fakultetin që ka sistemin “pitagora”), rezultatet e këtij pyetësi për të 7 fakultetet janë përpunuar dhe trajtuar nga DSBC duke ndjekur të njëjtën metodologji.

PËRMBAJTJE

HYRJE	1
1. BAZA LIGJORE	3
1.1. LIGJI I ARSIMIT TË LARTË	3
1.2. KODI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË	3
1.3. STATUTI I UNIVERSITETI POLITEKNIK TË TIRANËS	3
2. ORGANIZIMI I PYETËSORIT	3
2.1. QËLLIMI I PYETËSORIT	3
2.2. HARTIMI I PYETJEVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	3
3. SISTEMI ELEKTRONIK I PYETËSORIT	4
3.1. GJENERIMI I TË DHËNAVE	5
3.2. ANONIMATI I STUDENTIT	5
4. METODOLOGJIA E PYETËSORIT	5
5. REZULTATET E ANKETIMIT	6
5.1. PJESËMARRJA NË ANKETIM	6
5.2. EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE NË NIVEL INSTITUCIONI	7
6. REZULTATET SIPAS FAKULTETEVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT	9
6.1. FAKULTETET PJESË E ANKETIMIT	9
6.2. PROGRAMET E STUDIMIT PJESË E ANKETIMIT	9
6.3. REZULTATET PËR ÇDO FAKULTET/PROGRAM STUDIMI	10
7. ANALIZA DHE REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT PËR ÇDO FAKULTET / PROGRAM STUDIMI	18
8. VLERËSIMET E PEDAGOGËVE	22
8.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	22
8.2. IDENTIFIKIMI I VLERËSIMEVE TË ULËTA	23
8.3. REKOMANDIMET DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT	23
9. ANEKSE TË PYETËSORIT	24
9.1. RANKIMET E FAKULTETEVE / PROGRAMEVE TË STUDIMIT	24
9.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE (TË DHËNA KONFIDENCIALE)	24

1. Baza Ligjore

1.1. Ligji i Arsimit të Lartë

Procesi i Anketimit të studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”:

Kreu X “SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”, Neni 103 “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, pika 1,2,3.

1.2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të përcaktuara në **VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”**, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë në të gjitha ciklet e programeve të studimit që ofron UPT:

SHTOJCA NR. 1, STANDARDET PËR SIGURIMIN E CILËSISË PËR INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, III. PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI, Standardi III.15 “Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përfitim të kompetencave”, Kriteri 4. “Institucioni mbledh në mënyrë të vazhdueshme mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies dhe ndërmerr procedura me qëllim përmirësimin.”

1.3. Statuti i Universiteti Politeknik të Tiranës

Statuti i UPT, parashikon aktivitetin e DSBC mbi procesin e anketimeve studentore sipas Nenit 79 “Njësia Qëndrore e Sigurimit të Cilësisë” pika 5/e.

2. Organizimi i pyetësorit

Me Urdhër të Rektorit **Nr.05, Datë 07.01.2025**, të gjitha sekretaritë mësimore përditësuan të dhënat mbi pedagogët në Sistemin Elektronik.

Plotësimi i pyetësorit filloi prej datës **15 Janar 2025**, deri më **25 Janar 2025** nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php>.

Për të garantuar pjesëmarrje dhe njohjen sa më të mirë me procesin, studentët u informuan përmes e-mail-it në lidhje me kohën e kryerjes së anketimit, mënyrën e plotësimit dhe rëndësinë e këtij procesi.

Nëpërmjet këtij pyetësori, çdo studenti ju dha mundësia të shprehë perceptimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të Universitetit shqetësime specifike. Plotësimi i pyetësorit bëhet për çdo lëndë dhe çdo pedagog që merr pjesë në mësimdhënie në semestrin aktual.

2.1. Qëllimi i Pyetësorit

Ky pyetësor ndihmon në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

2.2. Hartimi i pyetjeve dhe Kriteret e vlerësimit

Për të përmbushur qëllimin e këtij pyetësori, u mendua që pyetjet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar. Bazuar në eksperiencën të ngjashme si dhe në konsultime me stafin e UPT, u arrit në hartimin e 9 pyetjeve:

- (P1) Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor
- (P2) Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor
- (P3) Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor
- (P4) Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta
- (P5) Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.
- (P6) Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor
- (P7) Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik
- (P8) Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi
- (P9) Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse
- (Nota) E vlerësoj me NOTEN:
- (Komenti)

Studenti ka të drejtën e vlerësimit të çdo pedagogu me pikë nga 1 deri në 5 për nëntë pyetjet e para, ku:

1 - është vlerësimi më i ulët

5 - është vlerësimi më i lartë


Për një vlerësim më të përgjithshëm studenti vendos edhe notë me vlerën nga 1-10.

Në fund, sipas dëshirës, studenti mund të japë edhe një vlerësim nëpërmjet një komenti me shkrim për pedagogun e lëndës.

3. Sistemi elektronik i pyetësorit

Për të krijuar një ide sa më të qartë të funksionimit të sistemit, hapat e ndjekur për plotësimin e pyetësorit, paraqiten në vijim:

1. Hyjmë në faqen zyrtare të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php>.
2. Zgjedhim Universiteti Politeknik i Tiranës.
3. Zgjedhim Fakultetin ku studiojmë.
4. Me hyrjen në portal, zgjedhim opsionin **“Anketim për Pedagogët”**.
5. Ndiqen instruksionet e nevojshme për plotësimin e pyetësorit.
6. Pasi të plotësohet pyetësori, shtypim butonin **“Prano të Gjitha Vlerësimet e Mëposhtme”**.
7. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi **“KUJDES, nuk ju përgjigjët të gjitha pyetjeve”**, atëherë duhet të kthehemi mbrapsht për të plotësuar të gjitha pyetjet.
8. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi **“Vlerësimet tuaja u memorizuan. Faleminderit për kontributin”**, atëherë pyetësori është plotësuar me sukses.



3.1. Gjenerimi i të dhënave

Pas përfundimit të anketimit, të dhënat e përfuara gjenden të koduara (enkriptuara) format Excel, me këto informacione kryesore:

IDa	Fakulteti	Pedagogu	StMD5p2	Grupi	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Nota	Koment	Lenda
1782	XXX	XXX XXX	f5e27071836548cba4cbcd42e6badf84	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17106	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebeec89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17107	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebeec89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX

Gjenerimi i të dhënave është i njëjtë, si për fakultetet që kanë përdorur sekretarinë mësimore “Bit-Albania”, ashtu edhe për fakultetin që ka përdorur sekretarinë mësimore “pitagora”.

3.2. Anonimati i studentit

Përgjigjet e pyetësorit gjenerohen dhe përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore për të evidentuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Në çdo rast, analiza e të dhënave të pyetësorit përcillet në fakultete pas përmbylljes së sesionit të provimeve, duke shmangur kështu çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

4. Metodologjia e pyetësorit

Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara nga sistemet (“Bit-Albania” dhe “Pitagora”), u realizua një analizë statistikore në disa nivele:

- Nivel Institucioni
- Nivel Fakulteti
- Nivel Programesh Studimi
- Nivel Pedagogu

Në këtë mënyrë, u llogarit për të gjitha nivelet e analizës mesatarja aritmetike për çdo pyetje nga **P1** deri në **P9**, mesatarja aritmetike për vlerësimin me notë dhe sipas Formulës së Rankimit. Gjithashtu, për rezultatet në nivel Institucioni është llogaritur edhe moda dhe mediana, si tregues më të avancuar të trendit të përgjigjeve.

Formula e Rankimit është një instrument vlerësimi kompleks ku komponentë të ndryshëm kanë peshë të ndryshme në raport me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë. Gjithsesi, studenti bën një vlerësim me notë dhe vihet re që formula e propozuar dhe vlerësimi i përgjithshëm i studentit nuk kanë shpangje domethënëse.

Vlerësimi sipas formulës së rankimit është një vlerësim që del si rezultat i mesatares së ponderuar të 9 pyetjeve, ku secila nga këto të fundit shumëzohet me një koeficient që i referohet peshës së pyetjes në formulë.

- **(P1)** Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor (X 5%)
- **(P2)** Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor (X 20%)
- **(P3)** Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor (X 20%)
- **(P4)** Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta (X 5%)
- **(P5)** Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës. (X 10%)
- **(P6)** Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor (X 10%)
- **(P7)** Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik (X 15%)

- (P8) Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimit (X 5%)
- (P9) Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse (X 10%)

Formula e Rankimit :

Vlerësimi= P1x5% + P2x20% + P3x20% + P4x5% + P5x10% + P6x10% + P7x15% + P8x5% + P9x10%

5. Rezultatet e anketimit

5.1. Pjesëmarrja në Anketim

Pas përpunimit të të dhënave për të 7 Fakultetet, numri i anketimeve është **6359 ANKETIME**, të shpërndara sipas Fakulteteve përkatëse.


Sipas rregullave të anketimit, një student plotëson anketimin për lëndët që frekuenton si student i rregullt në këtë semestër. Studentët përsëritës nuk janë pjesë e anketimit, pasi ata kanë të drejtën e shprehjes nëpërmjet anketimit vetëm një herë, në momentin që e ndjekin lëndën për herë të parë.

Numri i studentëve pjesëmarrës në anketim për të gjitha Fakultetet është: **1114 STUDENTË**.

NR.	FAKULTETI	NR I ANKETIMEVE	NR I STUDENTËVE PJESËMARRËS	*NR I STUDENTËVE/FAKULT ET	% E STUDENTËVE PJESËMARRËS
1	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	1386	212	707	30.0%
2	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	247	45	372	12.1%
3	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	1344	206	683	30.2%
4	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	236	53	123	43.1%
5	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	933	124	1150	10.8%
6	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	1207	195	1399	13.9%
7	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1006	279	857	32.6%
	TOTALI	6359	1114	5291	21.1%

**Duhet të theksojmë faktin se numri total i studentëve për secilin fakultet i referohet numrit të studentëve të rregullt të raportuar nga sekretariatë mësimore në Janar 2025.*

5.2. Evidentimi i problematikave në nivel Institucioni



Nga përpunimi i të dhënave në rang Institucioni është bërë një përmbledhje e vlerësimeve mesatare për secilën nga pyetjet si dhe për vlerësimet me notë (grafiku i mësipërm). Gjithashtu, është bërë dhe analiza e vlerave të modës dhe medianës për të krijuar një ide më specifike mbi trendin e vlerësimit.

Bazuar në analizën e rezultateve të pyetësorit të zhvilluar me studentët, janë identifikuar dy fusha që kërkojnë vëmendje të shtuar:

P3: Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor. **4.629**

P9: Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse. **4.613**

Në fushat e shkencave inxhinierike, ku konceptet shpesh mund të jenë të ndërlikuara dhe të bazuara në matematikë dhe teori të thella, qartësia e pedagogëve është kyçe për suksesin e studentëve.

Për të përmirësuar këtë aspekt shumë të rëndësishëm, DSBC rekomandon:

- Të trajnohen pedagogët në përdorimin e gjuhës të thjeshtuar dhe të qartë gjatë ligjëratave.
- Përdorimi i materialeve vizuale (grafikë, slide, video) për të ilustruar konceptet kyçe.
- Mësim interaktiv dhe diskutime në grup

Nxitja dhe motivimi i studentëve kërkon një qasje të shumëanshme që përfshin pedagogët, kurrikulën, ambientin e të mësuarit dhe mënyrën e vlerësimit. Disa rekomandime janë:

- Të krijohen mundësi për pjesëmarrje aktive në mësim përmes projekteve dhe punës praktike.
- Të inkurajohet përdorimi i metodave të mësimdhënies interaktive (debate, diskutime, studime rasti).
- Të përfshihen aplikime të drejtpërdrejta të lëndës në situata reale, si dhe krijimi i mundësive për studentët që të shprehin mendimet dhe pyetjet e tyre.
- Mbështetje psikologjike dhe orientim profesional ku përfshihet këshillimi akademik dhe motivimi personal është shumë i vlefshëm, sidomos në vitet e para.

6. Rezultatet sipas Fakulteteve dhe Programeve të Studimit

6.1. Fakultetet pjesë e anketimit

Fakultetet pjesëmarrëse në anketim janë

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
7. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Vlen të theksohet fakti që edhe pse janë përdorur dy sisteme sekretarie të ndryshme (Bit-Albania, administruar nga DSBC dhe “pitagora” për fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, administruar nga FIM), metodologjia e ekstraktimit të të dhënave, ruajtjes së anonimatit, pyetjeve/pohimeve të përdorura dhe dorëzimit të tyre ka qënë e ngjashme. Në rastin e sistemit “pitagora” nuk ka patur hapësirë për të paraqitur komentet e studentëve.

Për rrjedhojë rezultatet e përfuara janë trajtuar njësoj gjatë gjithë këtij raporti, në të gjitha nivelet e përmendura në pikën 4 të tij.

6.2. Programet e Studimit pjesë e anketimit

Nga analiza e të dhënave paraprake, janë evidentuar 51 Programe Studimi të cilat kanë qënë pjesë e këtij anketimi.

Për të përcaktuar numrin e anketimeve të cilat nuk përbëjnë statistikë, duhet marrë në konsideratë që një Program Studimi duhet të ketë një numër minimal studentësh pjesëmarrës, atëherë rezultatet e vjela do të quhen të vlefshme në ato Programe Studimi të cilat kanë një numër anketimesh më të madh se **50**. Nga sa më lart, rezultatet në vijim të këtij raporti nuk përfshijnë 29 Programe Studimi të cilat kanë më pak se 50 anketime.

Tabela në vijim jep programet e studimit të cilat kanë **më shume se 50 anketime**. Për këto programe është kryer një analizë më e detajuar në vijim të raportit.

NR.	FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT	NR. I ANKETIMEVE
1	FAU	Master i Shkencave në Arkitekturë; Profili Arkitekt	832
2		Master i Shkencave në Arkitekturë; Profili Urbanist	427
3		Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Design	127
1	FGJM	Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike	52
1	FIE	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili: Energetikë	433
2		Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili: Automatizim Industrie	375
3		Bachelor në Inxhinieri Mekatronike	295
4		Master Profesional në Elektroenergetikë	75
5		Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë	67
1	FIM	Bachelor në Inxhinieri Mekanike	378
2		Bachelor në Inxhinieri Ekonomike	199
3		Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike	172
4		Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode	96
5		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike	82
1	FIMF	Bachelor në Inxhinieri Matematike	115
1	FIN	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi	443
2		Bachelor në Inxhinieri Mjedis	230
3		Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi	129
4		Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike	67
1	FTI	Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni	427
2		Bachelor në Inxhinieri Informatike	373
3		Bachelor në Inxhinieri Elektronike	337


6.3. Rezultatet për çdo Fakultet/Program Studimi

Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e përfuara nga anketimi në rang fakultetit dhe në nivel programesh studimi.

Si për fakultetet ashtu edhe për programet e studimit janë identifikuar dy (ose me shumë) pohime me rezultat më të ulët.

● FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.697
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.607
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.587
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.624
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.603
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.605
P7	Komunikon dhe sillët brenda kuadrit etik.	4.744
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.551
P9	Nxat interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.561
FR	Formula e Rankimit	4.621
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.082
	NUMRI I ANKETIMEVE	1386



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Design	4.638	4.567	4.504	4.591	4.598	4.535	4.677	4.449	4.449	4.558	9.031	127
2	Masteri Shkencave në Arkitekturë; Profili Arkitekt	4.669	4.644	4.566	4.618	4.577	4.569	4.734	4.534	4.536	4.611	9.093	832
3	Masteri Shkencave në Arkitekturë; Profili Urbanist	4.768	4.546	4.651	4.646	4.656	4.698	4.782	4.616	4.642	4.658	9.077	427

● FAKULTETI I GJEOLIGJISË DHE MINIERAVE


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.789
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.753
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.640
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.737
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.741
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.664
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.822
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.725
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.644
FR	Formula e Rankimit	4.719
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.190
	NUMRI I ANKETIMEVE	247



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inzhinieri Gjeoinformatike	4.885	4.808	4.769	4.769	4.808	4.750	4.962	4.769	4.769	4.813	9.558	52

● FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.755
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.760
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.661
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.701
P5	Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.705
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.673
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.795
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimit.	4.672
P9	Nxít interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.644
FR	Formula e Rankimit	4.712
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.261
NUMRI I ANKETIMEVE		1344



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATORE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili: Automatizim Industrie	4.848	4.832	4.771	4.843	4.819	4.837	4.864	4.824	4.813	4.823	9.509	375
2	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili: Energjetikë	4.748	4.707	4.642	4.663	4.670	4.610	4.797	4.603	4.628	4.681	9.162	433
3	Bachelor në Inxhinieri Mekatronike	4.698	4.800	4.600	4.593	4.634	4.586	4.746	4.614	4.492	4.658	9.105	295
4	Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë	4.478	4.522	4.343	4.433	4.403	4.388	4.582	4.388	4.373	4.442	8.925	67
5	Master Profesional në Elektroenergjetikë	4.813	4.773	4.733	4.760	4.800	4.733	4.773	4.653	4.667	4.749	9.413	75

● FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKËS


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.623
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.619
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.415
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.470
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.449
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.424
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.640
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.492
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.394
FR	Formula e Rankimit	4.509
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	8.640
	NUMRI I ANKETIMEVE	236



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inxhinieri Matematike	4.574	4.609	4.209	4.339	4.278	4.209	4.496	4.391	4.191	4.371	8.243	115

● FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.825
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.745
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.675
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.736
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.797
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.667
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.857
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimit.	4.705
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.682
FR	Formula e Rankimit	4.741
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.340
	NUMRI I ANKETIMEVE	933



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inxhinieri Mjedis	4.887	4.857	4.765	4.839	4.861	4.865	4.896	4.883	4.835	4.845	9.535	230
2	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi	4.847	4.767	4.711	4.767	4.822	4.641	4.919	4.747	4.698	4.768	9.479	443
3	Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi	4.767	4.744	4.674	4.713	4.806	4.620	4.783	4.597	4.620	4.710	9.101	129
4	Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike	4.552	4.418	4.388	4.403	4.537	4.507	4.537	4.388	4.493	4.463	8.821	67

● FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT


NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.741
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.626
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.539
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.599
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.661
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.568
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.783
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.597
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.536
FR	Formula e Rankimit	4.624
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.036
NUMRI I ANKETIMEVE		1207



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Formula e Rankimit	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inzhinieri Elektronike	4.703	4.591	4.475	4.558	4.591	4.596	4.694	4.528	4.481	4.573	9.015	337
2	Bachelor në Inzhinieri Informatike	4.810	4.673	4.660	4.681	4.772	4.622	4.861	4.692	4.592	4.703	9.223	373
3	Bachelor në Inzhinieri Telekomunikacioni	4.689	4.576	4.466	4.539	4.614	4.489	4.756	4.546	4.506	4.571	8.827	427

● FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

NR.	PYETJA	VLERESIMI
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.817
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.763
P3	Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.755
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.776
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.	4.761
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.737
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.828
P8	Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.745
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.719
FR	Formula e Rankimit	4.767
	Nota (Mes. e UPT 9.205)	9.513
	NUMRI I ANKETIMEVE	1006



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	VLERESIMI SIPAS RANKIMIT P1-P9	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Bachelor në Inxhinieri Mekanike	4.823	4.741	4.759	4.765	4.778	4.738	4.815	4.749	4.743	4.765	9.548	378
2	Bachelor në Inxhinieri Ekonomike	4.824	4.759	4.714	4.754	4.744	4.729	4.834	4.724	4.668	4.749	9.447	199
3	Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike	4.837	4.797	4.849	4.849	4.814	4.802	4.872	4.802	4.762	4.822	9.640	172
4	Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode	4.656	4.646	4.625	4.656	4.531	4.552	4.750	4.635	4.583	4.631	9.073	96
5	Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike	4.768	4.756	4.671	4.695	4.707	4.671	4.732	4.634	4.683	4.706	9.476	82

7. Analiza dhe rekomandime për përmirësimin e treguesve të ulët për çdo Fakultet / Program Studimi

Rezultatet e paraqitura në pikën 5 të këtij raporti, tregojnë se në përgjithësi vlerësimi i studentëve në lidhje me fakultetin apo programin e studimit të tyre është i mirë (duke patur parasysh që vlerësimet janë mbi 4).

Referuar grafikëve më lart, vlerësimi maksimal (me 5) mbizotëron në cdo pohim të anketimit. Mbi 50% të studentëve janë plotësisht dakord me pohimet e pyetësorit dhe ky fenomen vërehet në të gjitha fakultetet. Megjithatë, ky rezultat nuk na bën të mendojmë se të gjithë janë të kënaqur dhe çdo gjë funksionon shumë mirë në fakultetin apo programin e studimit ku ata studiojnë.

Për këtë, kemi identifikuar dy pohimet me rezultate më të ulta si në rang fakulteti dhe në rang programi studimi. Mbi këto rezultate, DSBC ka hartuar disa rekomandime për marrjen e masave konkrete për zgjidhjen e problematikave në afate të caktuara dhe për monitorimin e vazhdueshëm të mbarëvajtjes së procesit.

Pasqyra e problematikave dhe rekomandimet për çdo Fakultet:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës:

➤ **Problematikat e Fakultetit:**

- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

➤ **Problematikat e Programeve të Studimit:**

Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Design

- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master i Shkencave në Arkitekturë; Profili Arkitekt

- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master i Shkencave në Arkitekturë, Profili Urbanist

- P2 - Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.

2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave

➤ **Problematikat e Fakultetit:**

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.
- 10 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ **Problematikat e Programeve të Studimit:**

Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P4 - Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

➤ Problematikat e Fakultetit:

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.
- 3 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ Problematikat e Programeve të Studimit:

Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjetikë

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.

Bachelor në Inxhinieri Mekanike

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, profili Automatizimi i Industrisë

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master Profesional në Elektroenergjetikë

- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizikës

➤ Problematikat e Fakultetit:

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.
- 5 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ Problematikat e Programeve të Studimit:

Bachelor në Inxhinieri Matematike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

➤ Problematikat e Fakultetit:

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- 3 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ **Problematikat e Programeve të Studimit:**

Bachelor në Inxhinieri Mjedisi

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P4 - Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.

6. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

➤ **Problematikat e Fakultetit:**

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.
- 3 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ **Problematikat e Programeve të Studimit:**

Bachelor në Inxhinieri Elektronike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Informatike

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.

7. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

➤ **Problematikat e Fakultetit:**

- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.
- 5 Programe Studimi me numër anketimesh nën 50 (Shih pikën 6.2)

➤ **Problematikat e Programeve të Studimit:**

Bachelor në Inxhinieri Mekanike

- P2 - Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.

Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.

- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike

- P2 - Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode

- P5 - Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.
- P9 - Nxiti interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.

Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike

- P3 - Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.
- P6 - Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.
- P8 - Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.

1.1.1. Rekomandimet:

Duke u bazuar në sa më sipër DSBC rekomandon marrjen e masave për përmirësimin e indikatorëve të renditur më sipër. Konkretisht, rekomandohet që masat të merren në dy nivele në përputhje me procedurën e mëposhtme:

Në nivel Departamenti:

- Njohja dhe prezantimi i Raportit të anketimit në departamentin përgjegjës për Programin/Programet e Studimit.
- Ngritjen e grupit të punës për analizimin e problematikave të evidentuara në raport për departamentin përkatës.
- Koordinimi me dekanatin për zgjidhjen e problematikave të evidentuara.

Në nivel Fakulteti:

- Njohja dhe prezantimi i Raportit të anketimit në Dekanat.
- Ngritjen e grupit të punës për analizimin e problematikave të evidentuara në raport për Fakultetin përkatës.
- Hartimin e planit të masave për përmirësimin e treguesve, në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Standardi VI.5, Kriteri 3.
- Raportimi me shkrim mbi ecurinë e procesit pranë Rektorit të UPT.

8. Vlerësimet e pedagogëve

8.1. Të dhëna të përgjithshme

Nga analiza e përgjithshme, numri i pedagogëve të regjistruar në anketim është **543 PEDAGOGË**.

Në fakt numri real i tyre është 468, por duke marrë parasysh se një pjesë e pedagogëve japin mësim në më shumë se një Program Studimi apo Fakultet, atëherë numri total që përftohet për efekt të anketimit është .

LISTA E PEDAGOËVE PJESË E ANKETIMI SIPAS FAKULTETEVE		
NR.	FAKULTETI	NR I PEDAGOGËVE
1	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	105
2	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	50
3	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	80
4	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	40
5	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	113
6	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	71
7	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	84
NUMRI TOTAL I PEDAGOGËVE		543

Ashtu si në analizimin e të dhënave në nivel Fakulteti apo në nivel Programesh Studimi, u krye edhe vlerësimi individual i çdo pedagogu, pjesë e këtij anketimi.

Vlerësimi i çdo pedagogu është bërë duke llogaritur mesataren aritmetike të vlerësimeve të marra nga çdo student, pavarësisht fakultetit ku ky student bën pjesë. Kjo do të thotë se, në periudhën e zhvillimit të anketimit, mund të ndodhë që një pedagog ka dhënë mësim në disa fakultete, rrjedhimisht mund të jetë anketuar nga disa studentë nga fakultete të ndryshme, por vlerësimi i tij bëhet vetëm një herë, mbi bazën e të gjitha vlerësimeve të marra.

Për çdo pedagog është llogaritur vlerësimi mesatar për çdo pyetje P1-P9, nota mesatare dhe vlerësimi sipas formulës së rankimit.

Për evidentimin e pohimeve rezultate më të ulëta në anketim u përdorën dy kritere bazë:

- Pohimi me një vlerësim mesatar më të ulët se 3.75 për çdo pyetje.
- Pedagogë që kanë një notë mesatare më të ulët se 7.5.

Në bazë të këtyre kritereve, është bërë analizimi dhe filtrimi i të dhënave dhe është hartuar një grafik ku ilustron shpërndarja e problematikave të evidentuar në % për çdo pyetje dhe për notën, sipas kritereve të mësipërme.

8.2. Identifikimi i vlerësimeve të ulëta


Në vijim të këtij raporti është bërë edhe renditja e pedagogëve sipas vlerësimeve (Të gjitha rezultatet e nxjerra për çdo pedagog ndodhen në Aneksë, pika 9.2).

Grafiku i mëposhtëm është një paraqitje e rezultateve (mesatarja) për pohimet 1-9 dhe notës sipas dy kriterëve bazë të përdorur për identifikimin e pedagogëve me rezultate të ulëta.

Në vijim janë vlerësimet që plotësojnë kriteret si më poshtë:

- Vlerësime me rezultat nën 3.75 nga 5 (për pohimet),
- Vlerësime me rezultat nën 7.5 nga 10 (për notën)

Nëpërmjet këtij grafiku tregohet si është shpërndarja në % e vlerësimeve të ulëta sipas kriterëve të përcaktuara më lart.



8.3. Rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët

Vlerësimi për çdo pedagog është një informacion konfidencial i cili i vihet në dispozicion vetëm Rektorit të UPT-së. Duke u bazuar nga analizat e mësipërme DSBC rekomandon ndjekjen e një procesi analize dhe hartimin e masave konkrete si më poshtë:

- Njoftimin e çdo pedagogu për rezultatet e tij në sondazh nëpërmjet një komunikimi konfidencial.
- Marrjen e masave individuale me qëllim përmirësimin e treguesve nga pedagogët të cilët rezultojnë me vlerësim të ulët bazuar në kriteret minimale të paraqitura në Pikën 7.2.

9. Aneke të pyetesorit

9.1. Rankimet e Fakulteteve / Programeve të Studimit

1. Rankimi i Fakulteteve sipas pyetjeve
2. Pasqyra e vlerësimeve nga 1 deri në 5 për 9 pohimet
3. Rankimi i Programeve të Studimit

9.2. Rankimi i Pedagogëve (të dhëna konfidenciale)

1. Rezultatet e anketimeve për secilin Pedagog.
2. Lista e pedagogëve me vlerësim mbi kriteret e vendosura.
3. Lista e pedagogëve me vlerësim të ulët në të paktën njërin prej kriterëve.
4. Renditja e pedagogëve sipas notave mesatare.
5. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P1.
6. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P2.
7. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P3.
8. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P4.
9. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P5.
10. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P6.
11. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P7.
12. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P8.
13. Renditja e pedagogëve sipas pyetjes P9.
14. Renditja e pedagogëve sipas pyetjeve P1-P9 (Sipas Formules së Rankimit).
15. Skedat e çdo pedagogu me vlerësimet dhe komentet përkatëse.

Grupi i Punës:

Prof. Asoc. Gjergji Islami

Drejtues grupi dhe hartues i procesit.

Dr. Romeo Teneqexhi

Programues i Sistemit Elektronik

Besmira Poçi

Analiza dhe përpunimi i të dhënave, Hartimi i Raportit